



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DIBËR

## NJOFTIM

### PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR POZICIONIN E PUNËS “KOORDINATOR”

**POZICIONI:** Koordinator për asistencën ndaj subjekteve me status të  
posaçëm

**INSTITUCIONI:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër

**AUTORITETI I EMËRTESESË:** Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër

- **Përgjegjësitë dhe funksionet që parashikon pozicioni i punës së “Koordinatorit”:**

Koordinatori do të ketë si përgjegjësi kryesore përmbushjen e detyrimeve të prokurorisë për informacion ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, referimin e viktimave tek ofruesit e shërbimeve dhe garantimin e mundësive për ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre. Punonjësi ndihmon çdo pjesëmarrës në procedim që ka një paaftësi fizike apo mendore për të ushtruar me efektivitet të drejtën për akses në sistemin e drejtësisë penale.

Gjithashtu ofron shërbime dhe këshilla për viktimat e krimit, në veçanti për ato të kategorive të mëposhtme: të miturit; viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual dhe përndjekjes; viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe viktimat me paaftësi fizike dhe intelektuale, duke pasur parasysh moshën dhe situatën specifike.

U shpjegon viktimave procesin e drejtësisë penale dhe procedurat e ndryshme gjyqësore. Merr informacion, siguron mbështetje emocionale dhe ndërhyrje në rastet e krizës si dhe bën referime tek ofruesit shtetëror dhe ato jofitimprurës të shërbimeve. Shërben si ndërlidhës ndërmjet prokurorit të rastit dhe viktimës.

Kryen detyrat nën drejtimin e prokurorit të çështjes dhe brenda kufijve të sekretit hetimor. Në rast mospërputhjes i raporton ato tek prokurori i çështjes. Mban kontakt me viktimën dhe dëshmitarin gjatë fazave të procedimit penal, duke dhënë mbështetje emocionale dhe informacion praktik, sipas nevojës.

Vepron si ndërlidhës me agjensitë e arsimit dhe shërbimet sociale në komunitet. Krijon dosje të rasteve, sipas udhëzimeve të marra nga drejtuesi i prokurorisë. Përditëson rregullisht udhëzimet, politikat dhe procedurat standarde të operimit të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.

Kryen detyra të tjera që i caktohen nga prokurori apo drejtuesi i prokurorisë.

- **Kushtet e Përgjithshme, të posaçme dhe të preferuara por jo të nevojshme që duhet të plotësojë kandidati.**

**Kushtet e përgjithshme:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim apo gjykim në një process penal;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi në momentin e konkurrimit;
7. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për psikologji, sociologji, ose fusha të tjera të ngjashme.

**Kushtet e posaçme:**

1. Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë, ofruesit e shërbimeve, që operojnë në komunitet, viktimat dhe publikun;
2. Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive dhe me takt me viktimat emocionalisht të shqetësuara;
3. Të ruajë sekretin hetimor;
4. Të ruajë konfidencialitetin e informacionit të viktimës;
5. Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale;
6. Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me viktimat e krimit;
7. Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si: Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.;

**Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:**

1. Njohja e shërbimeve që u ofrohen viktimave të krimit nga ofrues të ndryshëm shtetërorë dhe jo qeveritarë;
2. Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

- **Kandidatët për pozicionin e lirë të punës “Koordinator” duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

1. Kërkesë me shkrim për punësim;
2. Fotokopje e letërnjoftimit /pasaportës;
3. CV (Jetëshkrim) të detajuar;

4. Fotokopje e diplomë e shkollës së lartë dhe listës së notave;
5. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
6. Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht .
7. Ç’do document tjetër (master, specializime, etj nëse ka).

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, **deri në datën 05.06.2019 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.**

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DIBËR**